



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Bazuar në nenin 73 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 4.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenin 58 paragrafi 2.10 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01.Nr.016-126211 të dates 06.11.2014, dhe Vendimit e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit Konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor, 01.Nr.016-41883 të datës 30.04.2015 , Kuvendi i Komunës së Gjiçanit shpall:

K O N K U R S

PËR ANËTARËSIM NË KOMITETIN KONSULTATIV TË EKSPERTËVE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR (SHTATË ANËTARË)

Të drejtë pjesëmarrje në konkursin për anëtarësim në Komitetin Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Gjiçanit, të cilët janë njohës të fushës së planifikimit hapësinor.

Përfaqësimi gjinor në Komitetin Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor duhet të jetë në kuotën 30%.

Kandidati për anëtar në Komitetin Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor duhet të jetë banor i Komunës së Gjiçanit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Jep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinor (Planin Zhvillimor Komunal, Planet zhvillimore për zona të veçanta dhe Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Gjiçanit) dhe në dokumentet tjera të përcaktuara me Ligjin për Planifikim Hapësinor të Kosovës, të cilat i nxjerr: Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Kuvendi i Komunës dhe organet e tij, nga fusha e planifikimit hapësinor, e që kanë ndërlidhje me territorin e Komunës së Gjiçanit.
- Shqyrton dhe propozon zgjidhje përkatëse në rastet e mos harmonizimit të strategjive zhvillimore për sektorë të ndryshëm të rëndësishëm për planifikimin hapësinor.
- Përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinor, të cilat miratohen nga organet e

Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, Kuvendit dhe ekzekutivit të Komunës së Gjilanit dhe organeve të tij, në vështirësi të Ligjit për planifikim hapësinor dhe akteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor.

- Jep propozime për rregullore të ndryshme në lëmin përkatës.
- Jep mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmerr Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës, në fushën përkatëse
- Paraqet pikëpamje dhe mendime të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Paraqet propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara
- Paraqet ide apo propozime për hulumtime të ndryshme nga lëmi i planifikimit hapësinor
- Kryen edhe punë të tjera që dalin nga aktet juridike të organeve kompetente nga fusha e planifikimit hapësinor.

Mandati:

- Mandati i parë i anëtarëve të Komiteteve Konsultative të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor është 3 (tre) vjeçar, në baza të rregullta, ku 1/3 (një e treta) e anëtarëve duhet të ndërrohet çdo vit.
- Anëtarët e Komiteteve Konsultative mund të shërbejnë më së shumti për dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të Komitetit Konsultativ të Ekspertëve të Planifikim Hapësinor.

Kompensimi:

Për punën e tyre, anëtarët e Komitetit Konsultativ të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor do të kompensohen konform me dispozitat e nenit 9 të Udhëzimit Administrativ nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në Komuna.

Përgatitja profesionale e kërkuar:

- Diplomë universitare nga fusha e planifikimit hapësinor
- Përvoja e punës dhe njohja e punës me kompjuter janë të preferuara.

Dokumentet e kërkuara:

- CV
- Diplomë universitare nga fusha e planifikimit hapësinor
- Referencat për aktivitetin
- Kopje e letërnjoftimit
- Certifikata e vendbanimit
- Dëshmia që nuk është nën hetime

Kandidatët të cilët konkurrojnë, do t'i nënshtrohen intervistimit nga paneli përzgjedhës i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara, është 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date, nuk do të shqyrtohen.

Dorëzimi i dokumenteve të kërkuara mund të bëhet çdo ditë pune, nga ora 8:30-15:30, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/